

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME ORTAK TË VETËM  
“ACELEON SECURITY” SHPK**

**NENI 1**

**THEMELIMI I SHOQËRISË**

1. Sot më datë **05/08/2021** themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “ACELEON SECURITY” shpk, (Në vijim referuar si “Shoqëria”).
2. Shoqëria është person juridik shqiptari cili operon në fushën e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike sipas ligjit nr. 75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.
3. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.
4. Shoqëria përbëhet nga një Ortak i Vetëm, me të dhënat e mëposhtme:
  - **Leon Frroku**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, lindur më 24.09.2001 në Tiranë, banues në Tiranë në Rrugën “Luan Zelka” Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. personal K10924054S, i cili zotëron 100 % të kuotave të shoqërisë.
5. Ortaku i Vetëm i shoqërisë zotëron një kuotë në masën 100 % me vlerë 1.000 (një mijë) lek.

**NENI 2**

**FORMA E SHOQËRISË**

1. Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë që Ortaku i vetëm i kësaj shoqërie nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.
2. Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të shoqërisë, dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, në përputhje me ligjin nr. 75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.si dhe aktet e të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë objektin e veprimtarisë.

**NENI 3**

**EMËRTIMI**

1. Emërtimi i shoqërisë është “ACELEON SECURITY” sh.p.k. Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet sh.p.k.

**NENI 4**

**SELIA E SHOQËRISË**



1. Shoqëria e ka selinë në adresën: Rruga “Leonard Frroku”, Nr. 2, Unaza e Re, Tiranë, Shqipëri.
2. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, degëve, agjensive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një Vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

#### **NENI 5** **KOHËZGJATJA**

4. Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat.
5. Në përputhje me Statutin, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj në çdo kohë e kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

#### **NENI 6** **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

1. Veprimtaria e shoqërisë është në përputhje me ligjin Nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” me objekt:
  - Shërbime të ruajtjes dhe sigurimit të objekteve shtetërore dhe private, i personave si dhe i veprimtarive social-kulturore sportive, fetare e politike (kategoria I.3.A);
  - Importim, tregtim, transportim dhe instalimin e mjeteve të sistemit vrotues, sinjalizues, audioviziv, mjeteve të mbrojtjes kundra zjarrit, pajisjeve të ndërlihdjes, sistemeve të kontrollit dhe monitorimit në distancë etj., të lejuara/ parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Përveç aktiviteteve të parashikuara më lart, në objektin e veprimtarisë të Shoqërisë do të përfshihet çdo veprimtari tjetër që nga Ortaku do të konsiderohet e nevojshme dhe e përshtatshme për të përmbushur objektin e Shoqërisë dhe që nuk ndalohej nga ligji, ndryshime të cilat miratohen me Vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm dhe njoftohen për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Aktivitetet e Shoqërisë, për të cilat kërkohet paraprakisht një leje, licensë, autorizim apo ndonjë akt tjetër miratues, do të ushtrohen pasi të jete marrë akti në fjalë.

#### **NENI 7** **EMBLEMA, VULA**

1. Shoqëria do të ketë emblemën/ stemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga Asambleja e Ortakut të Vetëm dhe nga administratori i shoqërisë.
2. Forma dhe përmasa e vulës do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakut të Vetëm pas regjistrimit të saj, në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar. Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj.



**NENI 8****KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 1.000 (një mijë) Lek. Kontributi i Ortakut përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
2. Pjesëmarrja e Ortakut në Shoqëri është në raport me kontributin e tij dhe vlera nominale e kuotës së tij, e paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emri i Ortakut	Kuota	Vlera	Përqindja %
1.	Leon Frroku	1	1.000 lekë	100
	TOTALI	1	1.000 lekë	100

3. Ai mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm sipas normave të fushës në fuqi.
4. Kapitali është shlyer tërësisht.

**NENI 9****ADMINISTRATORI****Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet**

1. Administratori do të përfaqësojë Shoqërinë dhe do të jetë ligjërisht përgjegjës për aktivitetet e Shoqërisë. Administratori do të menaxhojë dhe drejtojë veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë duke siguruar që menaxhimi i Shoqërisë të bëhet në mënyrë të ligjshme dhe në interes të Shoqërisë. Duke qenë përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë, Administratori ka të drejtën të nënshkruajë aktet dhe dokumentat e Shoqërisë, përfshirë hartimin e të gjitha vendimeve të Shoqërisë.
2. Caktimi i Administratorit bëhet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë riemërimi nga Ortaku i Vetëm. Administrator i shoqërisë do të jetë njëkohësisht Ortaku i Vetëm i saj, z. **Leon Frroku**, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, lindur më 24.09.2001 në Tiranë, banues në Tiranë në Rrugën "Luan Zelka" Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. personal K10924054S

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikatat tregtare;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare në marrëdhënie me të tretet, personalisht ose me përfaqësim, tek palët e treta, institucione apo entitete publike;

- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) mbajë një regjister të veçantë ku të bëjë regjistrimin e të gjitha Vendimeve të Ortakut të Vetëm.
- e) mbajë korespondencë të rregullt me të tretët, si dhe të marrëtë gjitha masat që kjo të jetë e arkivuar në arkivën e shoqërisë;
- f) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve,
- g) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në Ligjin përkatës, Statut apo në kontratë sipas rastit.

#### **NENI 10**

#### **PËRFAQËSIMI**

1. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Administratori mund të autorizojë një të tretë, me anë të një prokure të posaçme apo autorizim sipas rastit, për realizimin e tagrave të tij si dhe për ato kompetenca që i lindin në bazë të Ligjit Tregtar.

#### **NENI 11**

#### **DREJTUESI TEKNIK**


1. Drejtuesi teknik i është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë për drejtimin, menaxhimin dhe kontrollin e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike.
2. Marrëdhëniet ndërmjet titullarit të subjektit me drejtuesin teknik, rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në funksion të regjistrimit të shoqërisë, Drejtuesi teknik përcaktohet në Statutin e shoqërisë dhe në rast të largimeve apo ndryshimeve të Drejtuesit Teknik të emëruar, administratori i shoqërisë njofton për regjistrim këto ndryshime në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 12**

#### **DISPOZITA TRANZITORE DHE TE FUNDIT**

1. Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Akt Themelimi që lidhet me funksionimin e shoqërisë, zbatohet Statuti i regjistruar i shoqërisë dhe legjislacioni shqiptar sipas dispozitave përkatëse.

2. Caktohet administratori i shoqërisë ose një person i autorizuar prej këtij të fundit për regjistrimin fillestar të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
3. Ky Akt Themelimi hartohet në 5 kopje origjinale, dhe hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të tij dhe prodhon efekte ndaj të tretëve nga data e regjistrimit të tij në QKB.



---

ORTAKU I VETËM

**LEON FRROKU**